



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:017610
Datë: 08.05.2024
Numri i dokumentit: 05665114

PPP.nr.5/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.H. nga fsh, Komuna e Ferizajt, të cilin me autorizim e përfaqëson av Vllaznim Aliaj nga Ferizaj, kundër debitorit “M.-M.C. – B&A C., me seli në Prishtinë, rr “...”, nr.1..., me pronar A.P., e këtë me autorizim e përfaqëson Kompania e Avokateve Arbresh, me seli në Prishtinë, rr “Brigada 153”, D.R., H..., av Adnan Pacolli nga Prishtina, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit “M.– M.C. – B&A, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.654/2023, të datës 26.12.2023, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat B.A. nga Ferizaj, dhe **MBETET në fuqi** urdhri për përmbarim P.nr.654/2023, i datës 26.12.2023

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.654/2023, të datës 26.12.2023, Përmbaruesi privat B.A., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori N.H., kundër debitorit “M. – M. C. – B&A C., për pagesën e borxhit në shumë prej 44,612.57 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 04.07.2017, e deri në pagesën definitive, rentën mujore prej 298.98 euro nga data 01.09.2019, e arritur për pagesë deri më datën 20.12.2023, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 4,763.35 euro, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit në shumë prej 312 euro, në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, në bazë të aktgjykimit C.nr.539/17, të datës

17.12.2019, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, dhe aktgjykimit A.C.nr.1193/2020, të datës 25.10.2023, të lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit dhe nga shuma e fituar nga shitja e sendeve të debitorit të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, i autorizuari i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e të autorizuarit të debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim të atakuar me prapësim dhe pretendimet në prapësim të autorizuarit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi i të autorizuarit të debitorit është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara në nenin 71, par 1, të LPP-së.

Në të vërtetë, Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim P.nr.654/2023, i datës 26.12.2023, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat B.A., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të debitorit në prapësim se urdhri përmbarimor është në kundërshtim me dispozitat e procedurës përmbarimore pasi që debitorit i është dorëzuar vetëm propozimi për përmbarim dhe urdhri dhe jo edhe dokumenti mbi bazën e të cilit është kërkuar përmbarimi, në këtë rast propozimit për përmbarim i mungon vet dokumenti dhe objekti i përmbarimit pasi që debitori nuk është i pajisur me një shkresë të tillë, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga aktgjykimi i nxjerrë nga gjykata e shkallës së dytë, respektivisht Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë A.C.nr.1193/2020, i datës 25.10.2023, konstatohet se debitori kishte ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, C.nr.539/2017, të datës 17.12.2019, dhe fakti që debitori ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të përmendur më lart, nënkupton se debitori ka qenë i njoftuar me kopjen e aktgjykimit C.nr.539/2017, të datës 17.12.2019 dhe për shkak të mos respektimit të afatit partitiv (vullnetar) nga debitori për përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga aktgjykimi në fjalë, kreditori e ka shfrytëzuar të drejtën e tij që të kërkoj përmbarimin e dhunshëm të aktgjykimit C.nr.539/2017, të datës 17.12.2019. Për më tepër,

Gjykata konstaton se i autorizuari i kreditorit, propozimin për përmbarim e ka përpiluar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, sepse propozimi siç shihet e përmban kërkesën për përmbarim në të cilën është treguar dokumenti përmbarimor siç është aktgjykimi C.nr.539/2017, i datës 17.12.2019, në origjinal, kërkuesin e përmbarimit dhe debitorin dhe të dhënat e tyre rreth adresës së tyre, apo selisë së debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Po ashtu, Gjykata konstaton se Përmbaruesi Privat B.A., urdhrin për përmbarim P.nr.654/2023, të datës 26.12.2023, e ka nxjerrë në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 22, par 1, nën par 1.2, sepse aktgjykimi C.nr.539/2017, i datës 17.12.2019, konsiderohet dokument përmbarimor dhe siç vërtetohet, i njëjti është i pajisur edhe me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri, respektivisht është i plotfuqishëm nga data 25.10.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 22.12.2023, që nënkupton se në rastin konkret janë përmbushur edhe kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së.

Për më tepër, Gjykata vlerëson se aktgjykimi në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarim i atakuar me prapësim është në tërësi i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, për arsye se në të është treguar debitori dhe kreditori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit që është afati prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.5/24, më datë 08.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të